



Për : Z. Blendi Klosi, Minister i Turizmit dhe Mjedisit,

Blvd “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, Shqipëri. E-mail: info@turizmi.gov.al

Nga: Grupim i Shoqatave Mjedisore të Fushës së Mbrojtjes së Natyrës

Tiranë, 6 Nëntor 2019

I nderuar Z. Minister,

Ne, grupimi i 21 shoqatave jo-qeveritare të specializuara në fushën e mbrojtjes së natyrës, jemi informuar mbi nismën e Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për shqyrtim dhe vlerësim të Rrjetit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura me synim identifikimin e vlerave të veçanta të ruajtjes (kombëtare e ndërkombëtare), pastrimin e rrjetit nga zona që nuk përmbushin kriteret e shpalljes dhe propozimin e zonave të reja që duhen shpallur të mbrojtura për vlerat që kanë.

Në dijeninë tonë, AKZM ka kontraktuar për këtë qëllim Shoqatën Kombëtare të Parqeve të Shqipërisë (SHKPSH) e cila po sjell propozime për kufijtë e rinj të Zonave të Mbrojtura. Deri më tani SHKPSH ka organizuar me ndihmën e AKZM disa takime konsultative me një numër të kufizuar ekspertësh dhe me autoritete vendore ndonëse duhet theksuar se procesi i konsultimit ka qenë i përshpejtuar në organizim dhe i mangët në shpërndarjen e materialeve të duhura këshëllimore.

Ndërsa përshëndesim nismën për zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit të zonave të mbrojtura, shoqatat mjedisore janë të shqetësuara nga propozimi i SHKPSH dhe administratës përkatëse të angazhuar (AdZM dhe AKZM) për heqjen nga territori i Zonave të Mbrojtura të atyre sipërfaqeve që janë objekt i veprimtarive ekonomike të sotme apo që parashikohen të zhvillohen në të ardhmen. Në mendojmë se kjo qasje e dytë dhe e përshpejtuar është e gabuar sepse AdZM-të, AKZM dhe Ministria duhet të jenë garantuese të ruajtjes së integritetit dhe funksionalitetit ekologjik të Zonave të Mbrojtura dhe jo ndryshimit të tyre në përmbushje të kërkesave për zhvillim. Madje ne presim që institucionet e mësipërme të jenë pikërisht ato që duhet të mbrojnë territorin e ZM-ve nga kërkesat e palëve të tjera.

Ndërsa vlerësojmë gjithashtu përpjekjet shumëvjeçare për shtrirjen e rrjetit të ZM-ve në më shumë se 17% të territorit të vendit, do të ishte sot e papranueshme që këto territore të hiqen kaq lehtësisht nga harta e ZM-ve. Jo vetëm kaq, aktivitete ekonomike që sot duken si me ndikime të lehta mundet fare mirë të jenë fillimi i degradimit apo humbjes së plotë të funksioneve ekologjike dhe vetë territorit të Zonave të Mbrojtura.

Në të njëjtën kohë, ne kuptojmë fare mirë pozicionin e institucioneve përgjegjëse për Zonat e Mbrojtura përballë presionit gjithnjë e në rritje për aktivitete ekonomike e sidomos për projekte të infrastrukturës së energjisë së rinovueshme, transportit, turizmit dhe bujqësisë. Në shumicën e rasteve këto projekte po kërkojnë hapësira në Zonat e Mbrojtura bregdetare, ku pjesë të mëdha të territorit janë dhe prona shtetërore. Në shumicën e rasteve, këto janë pikërisht dhe sipërfaqet natyrore më me vlerë në Shqipëri dhe të shpallura si zona të mbrojtura të rëndësishme ndërkombëtare përfshirë Zona Ramsar, Zona Emerald, Zona të Rëndësishme për Shpendët (IBA), Zona Kyçe të Biodiversitetit (KBA) dhe Zona Pilot Natura 2000.

Në kushtet e mësipërme ne mendojmë se institucionet përkatëse për menaxhimin dhe ruajtjen e Zonave të Mbrojtura duhet të vlerësojnë përpjekjen e përbashkët e organizatave mjedisore për adresimin e çështjeve të zonave të mbrojtura. Në rastin më të keq, është detyrim i shoqërisë civile shqiptare të reagojë kur shikon apo dëgjon për veprime që mund të çenojnë vlerat e biodiversitetit dhe natyrës së Shqipërisë.

Pikërisht, për këtë arsye, marrë parasysh dhe ritmet e shpejta me të cilat po ecën procesi i rishikimit të Zonave të Mbrojtura, dëshirojmë të kërkojmë një takim konsultativ sa më të shpejtë me ju dhe administratën tuaj përgjegjëse për një diskutim gjithëpërfshirës të bazës ligjore për ndryshimet e propozuara, nevojës së ndryshimit konkret për secilën zonë të mbrojtur të ndryshuar dhe mënyrën se si ky ndryshim do të përmirësojë konkretisht zonën përkatëse, gjithë rrjetin e ZM-ve dhe larminë biologjike që strehon apo mbron ky rrjet.

Nga ana tjetër, kërkojmë që procesi i këshillimeve të zhvillohet konform ligjit dhe të marrë kohën e duhur pa përshpejtimin e nxitur që duket se po shoqëron sot këtë proces e sidomos diskutimet për nënzonimin e cdo Zone të Mbrojtur, diskutime që janë vështirësuar së tepërmi nga kontradikta ligjore mes neneve 13, 49 dhe 50 të ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” ku Nënzona Rekreative (Neni 50) rezulton të këtë shkallë mbrojtje më të fortë se Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm (Neni 49). Kjo është një arsye me shumë që të mos nxitojmë me këtë proces rishikimi të Zonave të Mbrojtura sepse nxitimi i sotëm mund të jetë më shumë pasoja për të ardhmen.

Falemnderit paraprakisht,

Organizatat anëtare të këtij grupimi ad-hoc

CC:

Znj. Ornela Çuçi, Zv/Ministre e Turizmit dhe Mjedisit

Z. Zamir Dedej, Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Znj. Klodiana Marika, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit